

VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.10(376)

TETOR 2019

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

FJALA


Simbol i mbijetesës, qëndrimeve dhe vlerave



Myfit GUXHOLLI

FAQE 2

MESAZHI



MOISIU: JETA E GJENERAL PARLLAKUT ËSHTË NJË HISTORI E LAVDISHME

FAQE 3

LAMTUMIRA



NUK KA VDEKJE PËR NJERËZ MADHËSHTORË SI GJENERAL PARLLAKU

Shpendi TOPOLLAJ

FAQE 4

Presidenti Meta, Ministria e Mbrotjtjes Xhaçka, kryebashkiaku Veliaj dhe personalitete të tjera publike dhe politike, homazhe për nder të jetës dhe veprës heroike të Gjeneral Parllakut

Lamtumirë gjenerali fitimtar i tri kohëve, Rrahman Parllaku



NGUSHELLIM

(me respekt të parave)
për jetën, veprën, sakrificat
dhe kontributet e tyre
që ju kanë bërë të mundur
nga i cili mesazhi të joshës!
I përjetshëm kujtim!

Ota Xhaçka
Ota Xhaçka

STUDIMI

**78 vjet më parë –
Qëndresa heroike në
Kodër të Kacës**

Nga Dine KACA

FAQE 8-9

DOSSIER

**Zyra e Shërbimeve Strate-
gjike (OSS) gjatë Luftës së
Dytë Botërore në Shqipëri!**

Nga Ervin DODA

FAQE 10

PORTRET

**DASHURIE LUMANI,
VETERANIA E PUNËS QË
NË VITET '70 GUXOITË
THYENTE MENTALITETET
E KOHËS DUKE U BËRË**

VINÇIERE

Nga Xheladin ÇELMETA

FAQE 11

Testamenti i atdhedashurisë

Halil RAMA

E përbashkëta e qindra mesazheve të personaliteteve publike e politike, si dhe qytetarëve të thjeshtë nga Shqipëria, Kosova e diaspora, në librin e ngushëllimeve që Protokolli Zyrtar i Shtetit hapi në ceremoninë e lamtumirës së gjeneral Parllakut, është atdhedashuria, si i vetmi testament që na la Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit. “Nëse dikush duhet quajtur sfidant i kohërave, ky është pa asnjë dyshim gjeneral Rrahman Parllaku. E sfidoi varfërinë në bjeshkët e Sharrit, sfidoi pushtimin e vendit me armë, shpirt e zemër; luftoi për çlirim-in e Shqipërisë, sfidoi diktaturën dhe u la brezave një shembull të madh virtyti dhe idealizmi”. Do të mjaftonte qoftë dhe vetëm ky shënim në librin e ngushëllimeve, i dy personaliteteve të letrave dhe politikës, Arta Dade e Namik Dokle për të profilizuar gjeneralin legendë në kufirin e tri kohëve.

(Vijon në faqen 5)

- META: Në udhëtimin e tij shekullor, Gjeneral Parllaku, jetoi luftën dhe paqen, fuqinë e pushtetit dhe persekutimin e pamëshirshëm, duke sfiduar kohët dhe regjimet, me përkushtim ndaj kombit, trimërinë dhe urtësinë e malësorit, shpirtin e lirisë dhe atdhedashurisë, duke mbetur i pathyer në çdo betejë që zgjodhi dhe iu imponua përgjatë 100 viteve**

FAQE 3

(me respekt të parave)
për jetën, veprën, sakrificat
dhe kontributet e tyre
që ju kanë bërë të mundur
nga i cili mesazhi të joshës!
I përjetshëm kujtim!

INTERVISTA E FUNDIT



**PARLLAKU:
Merita e Fadil Hoxhës
është se nuk lejoi
shpërbërjen e Kosovës**

Nga Aristir Lumezi

FAQE 6

PERCJELLJA

Homazhet u mbajtën në Muzeun Historik Kombëtar, të hënën e 16 shtatorit, të organizuara nga protokoll i zyrtar i shtetit

Përcillet Kryetari i OBVL, gjeneral Rrahman Parllaku, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit

Përmes një ceremonie shtetërore, më 16 shtator 2019, qytetarët e Tiranës përcollën me të gjitha nderimet që meritonte gjeneralin më jetëgjatë në Shqipëri, Rrahman Parllakun, në moshën 100-vjeçare.

Homazhet dhe nderimet e fundit gjeneral Rrahman Parllakut – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, iu dhanë në ambientet e Muzeut Kombëtar, aty ku ai kishte organizuar me dhjetëra konferenca dhe festime me veteranët e luftës. Garda e Republikës ishte e pranishme gjatë gjithë ceremoniale, ndërsa ora 14:00 shënoi daljen e arkëmortit, i cili u vendos mbi shtratin e topit për ta përcjellë me nderime nëpër rrugët e kryeqytetit.

Falë meritave dhe cilësive që lidhen me karakterin e gjeneral Parllakut, ai u nderua nga qytetarët të thjeshtë, anëtarë të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës, por dhe përfaqësues të institucioneve më të larta të vendit. Presidenti i Republikës, Ilir Meta, bëri homazhe dhe la një shënim në librin e përshtypjeve, ndërsa do ta cilësonte gjeneral Parllakun si “partizanin fitimtar antifashist, i cili më pas u burgos dhe u internua nga regjimi diktatorial”.

“Sot, që është një ditë historike për mbarë popullin dhe kombin tonë, 16



shtatori, Dita e Konferencës së Pezës, dita e besëlidhjes së të gjithë shqiptarëve pa dallim feje, krahine dhe ideje në luftën për liri, nuk e mendoja se do të ishte edhe dita kur do t'i thoshim lamtumirën e fundit gjeneralit Rrahman Parllaku, njërit prej komandantëve më të lavdishëm të Luftës Antifashiste, të luftës për liri, por edhe njërit prej personaliteteve më të mëdha të Ushtrisë sonë, një personaliteti publik me kontribute të jashtëzakonshme në të gjitha kohët”, u shpreh Presidenti Meta.

Në homazhe morën pjesë dhe kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, zv/

shefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Manushaqe Shehu dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj.

Për t'i dhënë lamtumirën gjeneralit fitimtar të tri kohëve, Heroit të Popullit që udhëhoqi luftën për çlirimin e Kosovës, që denoncoi me forcë edhe në arenën ndërkombëtare krimet e genocidit serb ndaj kosovarëve dhe që mbështeti fuqishëm pavarësinë e saj, kishin ardhur dhe një delegacion i Organizatës të Veteranëve të Kosovës, i kryesuar nga kryetari i kësaj Organizate, Zija Mulhaxha.

Ndërkohë, në bllokun e ngushëllimeve, dhejtra personalitete të jetës



politike e publike të vendit shprehën vlerësimet e tyre për gjeneralin legjendar, i cili më pas u përcoll mbi shtratin e topit për në banesën e përjetshme, në varrezat e Tufinës. Këtu fjala e lamtumirës u mbajt nga Nënkryetari i OBVL-së, kolonel Myfit Guxholli. Varri i tij u mbulua nga dhjetra kurora e tufa me lule.

FJALA

Simbol i mbijetesës, qëndrimeve dhe vlerave

Myfit GUXHOLLI*

Familjarë bashkëluftëtarë, bashkëpunëtorë, miq e dashamirë!

Me pikëllim të madh dhe dhimbje të thellë po i japim lamtumirën Gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku, partizanit dhe komandantit fitimtar antifashist, qëndrestarit të pamposhtur të burgjeve komuniste, veteranit me arsye dhe zë të kthjellët në mbështetje të demokratizimit të Shqipërisë, kryetarit të Organizatës tonë të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Ai ishte dhe mbetet model i mbijetesës, qëndrimeve dhe vlerave.

Vetëm para pesë muajsh atë e patëm mes nesh në jubileun e 100 vjetorit të tij, si dëshmitar okular të historisë së Shqipërisë dhe shqiptarëve, sublimitit dhe vlerave, arritjeve dhe gabimeve historike, luftërave dhe qëndrësive, ëndrrave dhe shpresave, që rriteshin e veniteshin nën një mbijetesë shekullore.

I lindur në Veri të Shqipërisë dhe rritur e formur në Jug dhe në Shqipërinë e Mesme, Gjeneral Parllaku e njohu Atdheun gjeografik me pëllëmbë, duke qenë prezent në të gjitha ngjarjet dhe sfidat e kohës, si pjesëmarrës aktiv në bëmata e mëdha në luftën për liri, dinjitet shoqëror dhe demokraci.

Ai lëviz në historinë e shekullit të tij, hijerëndë me vrytyte të larta, me përkushtim kombëtar, qytetar e shoqëror me ndikim të fuqishëm publik.



Jetën dhe veprën e tij nuk e nxënë kufijtë e Shqipërisë shtetërore, por atë do ta gjejmë në luftëra dhe përpjekje dhe në viset e tjera shqiptare, në mbrojtje të lirisë, pavarësisë dhe të drejtave të shqiptarëve.

Siç u shpreh mbrëmë Presidenti i Republikës, Z. Ilir Meta: “Në udhëtimin e tij shekullor, Gjeneral Parllaku, jetoi luftën dhe paqen, fuqinë e pushtetit dhe persekutimin e pamëshirshëm, duke sfiduar kohët dhe regjimet, me përkushtim ndaj kombit, trimërinë dhe

urtësinë e malësorit, shpirtin e lirisë dhe atdhedashurisë, duke mbetur i pathyer në çdo betejë që zgjodhi dhe iu imponua përgjatë 100 viteve.

Rrallë gjen shembuj të personalitetit ku të jenë jetësuar në mënyrë kaq mjeshtërore vetitë e karakterit të një patrioti, të një ushtaraku të mençur, fisnik, të ndershmë dhe patriot.

Rrugëtimin 100-vjeçar, Gjenerali Parllaku e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare.

Në jetën dhe veprën e tij janë ulur këmbëkryq urtësia e burrit të malësisë, trimëria, shpirti i lirisë dhe atdhedashuria e luftëtarit antifashist dhe e komandantit partizan, si dhe angazhimi qytetar plot përkushtim.

Si uji i kristaltë i lumit të bjeshkës ka rrjedhur jeta e këtij njeriu që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë 100 viteve.

Në 75-vjetorin e çlirimit të Atdheut, ndarja e tij nga jeta është një humbje e madhe për të gjithë ne, që mësuam aq shumë nga vepra e tij, jo vetëm për karakterin e pathyer të njeriut të drejtë, por edhe për luftën, sakrificat sublime dhe kontributet e jashtëzakonshme të popullit tonë gjatë Luftës së II Botërore.

Duke u shprehur familjes Parllakut, të afërmeve, bashkëluftëtarëve, bashkëpunëtorëve, miqve e dashamirësve të tij të shumtë, ngushëllimet më të sinqerta, shpreh bindjen e OBVL-së se emri dhe vepra e tij nuk do të ndahen kurrë prej nesh!

Lamtumirë Gjenerali ynë fitimtar!

U pufsh në paqe.

Parajsa qoftë vendbanimi juaj i përjetshëm!

* FJALA E NENKRYETARIT TE OBVL NE CEREMONINE E LAMTUMIRES TE GJENERAL PARLLAKUT - Tiranë, më 17.09.2019.

HOMAZH

Presidenti Meta, Ministria e Mbrojtjes Xhaça dhe personalitete të tjera publike dhe politike, homazhe për nder të jetës dhe veprave heroike të Gjeneral Parllakut


Lamtumirë gjenerali fitimtar i tri kohëve, Rrahman Parllaku

Presidenti i Republikës, Ilir Meta bëri, më 16 shtator 2019 bëri homazhe për nder të jetës dhe veprave heroike të Gjeneral Rrahman Parllakut, partizanit fitimtar antifashist, i cili më pas u burgos dhe u internua nga regjimi diktatorial.

Duke vendosur një kurorë me lule dhe duke u përlur me respekt para trupit të të ndjerit, Presidenti Meta u shprehu ngushëllimet familjarëve dhe të afërmve të tij dhe theksoi para përfaqësuesve të mediave:

“Sot që është një ditë historike për mbarë popullin dhe kombin tonë, 16 shtatori, dita e Konferencës së Pezës, dita e besëlidhjes së të gjithë shqiptarëve pa dallim feje, krahine dhe ideje në luftën për liri, nuk e mendoja se do të ishte edhe dita kur do t'i thonim lamtumirën e fundit Gjeneralit Rrahman Parllaku, njërit prej komandantëve më të lavdishëm të Luftës Antifashiste, të luftës për liri, por edhe njërit prej personaliteteve më të mëdha të ushtrisë sonë, një personaliteti publik me kontribute të jashtëzakonshme në të gjitha kohët.

Jam i bindur se përkushtimi i tij ndaj lirisë së atdheut, ndaj in-



Ish drejtuesi i formacioneve partizane në kohën e Luftës dhe gjenerali në paqe, Rrahman Parllaku ka ndruar jetë. Vec të tjerash ishte një mik i tim eti i cili nuk e hiqte nga goja edhe kur ai ishte në burg. Edhe për këtë arsye sa herë e takoja më nxirte mallin e tim eti që ndroi jetë përpara tij. Dhimbja sot për gjeneral Parllakun ka shumë kuptime. Një partizan më pak dhe një kujtim më shumë. Të qoftë dhe i lehtë gjenerali!

Partizanin me respekt përpara partizanit të fuqisë, por gjatë kësaj të parë të Tiranës - realiteti një simbol i qytetit në ditët e tij në të vërtetë si simbol se shqiptari i mirë i mbijetoi. Gëdo koha! Qafshë i paharruar Gjenerali Rrahman Parllaku! Me kujtimet në të mirë të një populli që të dënoi shumë.

Eduard Velin
Kra. Bashkësi Tiranë



teresave kombëtare, por edhe ndaj përparimit të demokracisë, do të mbeten përgjithmonë në kujtimin tonë.

Në përkujtimin e çdo ngjarjeje të rëndësishme të luftës, në çdo sukses të Atdheut, Gjeneral Parllaku me frymëzimin që na ka dhënë të gjithëve, padyshim që do të jetë gjithmonë mes nesh, me personalitetin e tij të pamposhtur, dhe me kthjelltësinë e mendimit që nuk e humbi asnjëherë”, u shpreh ai.

Po ashtu Presidenti Ilir Meta ka reaguar pas ndarjes nga jeta, të ish-gjeneralit Rrahman Parllaku, të dielen në darkë me 15 shtator. Në facebook, Meta shkruan kjo është një humbje e madhe, por shton se

vepra e tij nuk do të ndahen kurrë prej nesh

Postimi i plotë i Presidentit Meta:

Me pikëllim të madh dhe dhimbje të thellë mora lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të Gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku, partizanit dhe komandatit fitimtar antifashist, qëndrestarit të pamposhtur të burgjeve komuniste, veteranit me arsye dhe zë të kthjelltë në mbështetje të demokratizimit të Shqipërisë.

Në udhëtimin e tij shekullor, Gjeneral Parllaku, jetoi luftën dhe paqen, fuqinë e pushtetit dhe persekutimin e pamëshirshëm, duke sfiduar kohët dhe regjimet, me përkushtim ndaj kombit, trimërinë dhe urtësinë e malësorit, shpirtin e lirisë dhe atdhedashurisë, duke mbetur i pathyer në çdo betejë që zgjodhi dhe iu imponua përgjatë 100 viteve.

Në 75-vjetorin e çlirimit të Atdheut, ndarja e tij nga jeta është një humbje e madhe për të gjithë ne, që mësuam aq shumë nga vepra e tij, jo vetëm për karakterin e pathyer të njeriut të drejtë, por edhe për luftën, sakrificat sublime dhe kontributet e jashtëzakonshme të popullit tonë gjatë Luftës së II Botërore.

Duke u shprehur familjes Parllakut, të afërmve, miqve e dashamirësve të tij të shumtë, ngushëllimet më të sinqerta, jam i bindur se emri dhe vepra e tij nuk do të ndahen kurrë prej nesh!

Lamtumirë Gjenerali ynë fitimtar

Familjes të mikut dhe shokut tim të paharruar, gjeneral Parllakut!

Lajmin mbi ndrrimin e jetës për gjeneralin e mora jashtë Shqipërisë. Më tronditi, për mua ishte i papritur.

Kur i festuam 100-vjetorin, menduam se do t'i shtyjme edhe 10 vite të tjera me të, por këtë nuk e kemi ne në dorë.

Jeta e gjeneral Parllakut është një histori e lavdishme dhe e dhimbshme. Por asnjëri nuk e mbylli atë me aq respekt dhe benefite sesa ai.

Juve pasuesve të tij ju la një emër që do ketë vlera në vite. Jetoi sa ju pa juve të gjithëve të gëzuar dhe iku i respektuar nga një komb i tërë.

I paharruar kujtimi i tij. I qoftë i lehtë dheu. Gjeneral, u prehsh në paqe!

**Miku dhe shoku juaj
Alfred Moisiu**



LAMTUMIRA

NUK KA VDEKJE PËR NJERËZ MADHËSHTORË SI GJENERAL PARLLAKU


Shpendi TOPOLLAJI

16 shtatori, dita kur i dhamë lamtumirën e fundit gjeneral Rrahman Parllakut, ishte një ditë e lumtur për parajsën dhe një ditë e pikëllimit të thellë për të gjithë ne. Por dua të besoj se kushdo e ka të qartë, se ajo ditë kalonte përtej pikëllimit, pasi ne nuk po i hidhnim disa grushte me dhe një burri të rrallë dhe me kontribute të jashtëzakonshme në shërbim të popullit dhe atdheut, por po varrosnim vetë historinë e gjallë të Shqipërisë. Dhe pikërisht për këtë, gjeneral Rrahman Parllaku, jo vetëm i meritoi si pak kush titujt e lartë "Hero i Popullit" dhe "Nderi i Kombit", por dhe u cilësua njëzëri, një legjendë e vërtetë. Me jetën e tij prej mbi një shekulli, ai i dha vendit, shumë më tepër nga ç'mori prej tij, ndaj dhe me ndershmërinë, trimërinë, shpirtmadhësinë, përkushtimin, modestinë, fisnikërinë, atdhedashurinë, por edhe pamjen prej kreshniku që e karakterizonte, ai mbeti përfaqësuesi tipik i të gjithë vlerave dhe virtyeteve të racës tonë. E gjithë rruga plot tallaze prej nga kaloi jeta e tij; sukseset, pengesat, vështirësitë, privacionet dhe vuajtjet që e ndoqën, pra kurajua, durimi, shpirti i paepur dhe guximi me të cilat ai i përballoi pa u thyer asnjëherë, dashje pa dashje të kujtojnë lavdinë dhe kalvarin e Krishtit dhe shumë njerëzve të tjerë që mbetën në memorien e popujve si pika referimi, modele që duhen ndjekur dhe simbole krenarie.

Duke i qëndruar përherë besnik sentencës sokratike se "Secili ka detyrë për të kryer, dhe detyra më e lartë është kërkimi i të vërtetës, i drejtësisë dhe i mirësisë", ai, i urti e gojëmbëlli, ai njerëzori deri në kufijtë e të pabesueshmes, ai edukatori me shembullin vetiak, që do ta kishin zili edhe korifejtë e pedagogjisë, u kthye për këdo që e njohu, punoi apo dëgjoi intervistat e tij, që mori pjesë në

takime të ndryshme, apo lexoi artikujt e shumë në faqet e gazetave dhe librat që botoi, në një figurë e pastër si kristali, në një yll të ndritshëm udhërrëfyes drejt mirëkuptimit, paqes e përparimit. Në çdo rrethanë që u ndodh, edhe kur fati i ktheu krahët dhe e goditi pa mëshirë, duke e mbyllur poshtërsisht në hekura, ai asnjëherë nuk predikoi hakmarrje, veçsa theksoi nevojën e mirëkuptimit dhe harmonisë mes nesh. Kudo që e çoi ky fat, apo detyrat e ngarkuara, ai mbeti po ai: biri i denjë i Kukësit, drejtuesi syptrembur i guerillasve të Vlorës, komandanti i talentuar i Njësisë të mëdha partizane, mbrojtësi i zjarrtë i idealeve të Luftës Nacional - Çlirimtare, mirënjohësi ndaj familjeve që e mbrojtën gjatë ilegalitetit dhe zhvillimit të luftimeve si birin e tyre, Të gjithë ne që kemi qenë mvartësit e tij, e kujtojmë përherë me nderim e respekt të veçantë, këtë komandant e komisar të F.U.D. të Korpusit, Drejtor Drejtorie në Ministrinë e Mbrojtjes apo zëvendës ministër të këtij dikasteri, që dinte të kujdesej, t'i ndihmonte dhe përkrahte oficerët e ç'do rangui. Veç të tjerash, proverbiale mbetet vëmendja dhe dashuria atërore e tij për nxënësit e shkollës së mesme ushtarake "Skënderbej", prej nga, thosh, dalin kuadrot më të mira të ushtrisë.

Gjithmonë e kam pyetur veten se a mund të ketë ndonjë rast tjetër në të gjithë planetin që një ish luftëtar njëqind vjeçar, të rrezatojë aq energji e freski intelektuale dhe trupore, si dhe një kujtesë fenomenale, si madhështori Rrahman Parllaku. Se a nuk ishte ai njeriu që nuk u ankua kurrë, dhe pa ja ditur për vitet që i rëndonin mbi supë, gjente forca të jepte gjithçka kishte nga përvoja e vet për lirinë e Kosovës? Dhe a nuk ishte po ai që drejtoi me aq kompetencë, OBVL, duke e shndërruar atë në një institucion të vërtetë



demokratik, me synim pajtimin kombëtar. A nuk ishte pikërisht ai, që në ç'do takim ndërkombëtar ku merrte pjesë, me diskutimet e tij të mençura e plot argumente, dinte të fitonte simpatinë e cilitdo auditor? Gjeneral Rrahmani punoi sikur do të rronte edhe njëqind vjet të tjera, pasi ai ishte një mendje e hapur dhe ndihej tërësisht i lirë, ashtu sikurse thosh Ben-

edikt Spinoza se "Njeriu i lirë mendon më shumë për jetën se sa për vdekjen."

Kjo është edhe arsyeja përse për njerëz të tillë lumturohet parajsa dhe pikëllohem i ne.

Data 16 shtator që përkon me 77 vjetorin e Konferencës së Pezës, duket se është më e gjetura dhe më e bukura, për të mos thënë se është si e dekretuar nga Qielli, për t'i dhënë lamtumirën e fundit një njeriu e gjenerali si ai, që mbeti deri në fund zbatuesi më besnik i vendimeve të saj, për bashkimin e të gjithë shqiptarëve. Ja përse edhe të gjithë shqiptarët e rrethojnë me aq dashuri gegë - toskën Rrahman Parllaku dhe lusin të pushojë i qetë mes njerëzve më të mirë të Kombit tonë.

I përjetshëm gofë
hujtimi për Gjeneral
Rrahman Parllakun
biri trim dhe të
fjor të Lumës
martirë.
Arif Kallushi
16.09.2019

Nderimi dhe respekti të veçantë
jetoj dhe vlerësoj në vlerësimin
të Ro. Genllakut, biri i bukur të
vlerës dhe të vlerës të kombit
shqiptar. Kujtojmë dhe
gjeneratën e talentuar
e vlerës shqiptarë.
Me nderime
respekt e vlerësimin
Nasir Mehmeti
16.09.2019

Në shenjë nderimi e respekti për
Gjeneralin e Tërë, epokave simbol
i luftës i Paqes dhe i demokracisë.
Krenaria e Kontributit çlirimtar të
Shqipërisë!
Krenaria Funksionale dhe Kombëtare
"Hero i gjallë", me meritat të
Veçanta, simbol i atdhutardë
dhe vlerës "Kombëtare".
"I përjetshëm Rrejtimi Juaj",
I nderuar Gjeneral i Gjallë!
- Rrahman Parllaku -
Me nderime
Gjeneral Gëza
Arif, Kukës
dt. 16.09.2019

I parllaku gofë hujtimi
Gjeneral Rrahman Parllakut.
Kombi hui një. the sot të
mullit!
Puna, sakrificat e Gjeneralit
do të na ndihmojnë si yll
për gjithë popullin shqiptar
I shpreh ngushëllimet familjes!
2V/ Sh Sh P
Gjenerale Brigade
Man Shupe Sheher
16.09.2019

Lavdi e përjetshme "Heroit të
Popullit", dëshmitarit të Luftës Nacional
çlirimtare, bashkëkohësit, babait dhe
gjyshit shembullar, njeriut të sakrificave
e vëmendshmërisë njerëzore!
Nga familja e Aleksandria
Trenit, vëllezës së bashkë me
vajzën e shprehur me nderime
e urre me vlerë dhe që merr e
harmonia në një njeri. Të tjerë.
Mbesa e saj
Parlina Berisni
14.09.2019

I parllaku hujtimi
H. Sh. D. D.
Nderimi e respekti për vlerën e
Kombit, shenjë e Popullit, Gjeneral
Rrahman Parllakut!
Të tjerë
I shpreh ngushëllimet familjes!
Për ç'do sakrificat e sakrificave
e ngushëllimet e shqiptarëve të Kosovës
tonë
I shpreh ngushëllimet
u përjetshëm luftëtar
Eliminimi të shqiptarëve
Gjeneral Rrahman
16.09.2019

IN MEMORIAM

Gjeneral Parllaku ishjte dhe mbetet simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike

Testamenti i atdhedashurisë

(Vijon nga faqja 1)

Por në qindra mesazhet e ngushëltimeve për gjeneralin që “u fik në paqe dhe iku në këmbë” (siç shprehet gjeneral Piro Ahmetaj), kupton fare lehtë se Ai iku duke i lënë Familjes, bashkëluftëtarëve e bashkëpunëtorëve, shokëve e miqve në gjithë hapësirën mbarëshqiptare të vetmin testament, atë të atdhedashurisë...

Gjeneral Parllaku ishte ndër të paktët partizanë që jetoji dhe dëshmoi histori të tri kohëve, të partizanit e luftëtarit antifashist, heroit e komandantit ushtarak dhe atë të persekutimit komunist.

Ai ia doli mbi të gjitha furtunat e jetës, doli fitimtar nga Lufta Antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe deri para disa ditësh ishte gjenerali më i vjetër, por me mendje të re që mbështeste anëtarësimin e Shqipërisë dhe të ushtrisë shqiptare në NATO dhe integrimin e saj në BE.


Vetëm para gjashtë muajsh, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës”. Kryebashkiaku Veliaj e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Dhe në të vërtetë Ai qe kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike.

Shqiptarët ndjehen krenarë me jetën dhe veprën e Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit që bëri gjithshka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar.

Me gjeneral Parllakun ndihemi krenarë të gjithë . Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtytit familjar të trashëguar ndër shekuj.

Opinion i publik ka mirëpritur edhe librat e ndryshëm të shkruar nga gjenerali, siç është ai me titull: “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”, “Kosova, ëndrra e jetës sime”, dhe librin e sapobotuar me shtatë kapituj në 466 faqe “Një shekull në memorie”.

Me një kujtesë të jashtëzakonshme, me një mendjemprehtësi të madhe, gjeneral Parllaku ka bërë analiza brilante të situatave të vështira e delikate që ka kaluar vendi dhe ushtria jonë. Ë veçanta e gjithë “ligjëratave” të tij në shtypin e kohës dhe në veprimtari promovuese të librave kushtuar Luftës Nacionalçlirimtare e heronjve të saj, ka qenë gjykimi i tij tepër i saktë, konciz, realist, pa mllafe, pa paragjykime... Ai e ka vlerësuar



gjithnjë lart Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, arritjet dhe përpjekjet e popullit jo vetëm në rindërtimin e Shqipërisë së pasluftës, por edhe ato në fushën e arsimit, shërbimit shëndetësor, zhvillimit në tërësi të vendit, përfshirë edhe arritjet në mbrojtjen e fuqizimin e ushtrisë...si dhe këto vite të demokracisë e pluralizmit.

NGA JETA E KËTIJ MATUZALEMI NA ULET KËMBËKRYQ HISTORIA

Nga jeta e këtij Matuzalemi na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur... Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut si veteran në këtë çerek shekulli të demokracisë mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Në spiralet e historisë, Gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet duke patur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liri-dashës. Vështirë të përmbledhësh në

pak radhë, në kuinesencë, motivimin e personalitetit të tij, zhvillimin konjitiv e psikomotor të këtij djaloshi që ngjitej nga Novosej i Kukësit në Tribuna të larta shtetërore, në hero të popullit të tij, në drejtues madhor ushtarak, duke ndryshuar variablat në kontekste politike në funksion të mbijetesës dhe qëndresës, nga udhëheqës i shquar në të dënuar me burg, nga triumfator në grigjë të rrezikut për jetën, nga piedestali i kuadrit të dobishëm në stigmën e “njeriut të rrezikshëm”, ekstreme këto që provokuan në personalitetin



e Tij, qëndrime dhe vlera të larta politiko-shoqërore në raportin e ndjenjave të forta estetike midis dashurisë dhe urrejtjes. Këtë volum ideor dhe estetik e përcjell përgjatë shekullit të jetës së tij, një burrë shtetar, një organizëm vital, një mendje koherente dhe një vizion largpamës dhe perspektiv.

HEROI QË FITOI DUKE MERITUAR LAVDINË DHE PAVDEKËSINË

Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e Gjeneral Parllakut, atë e përshkon frymëzimi dhe dashuria për Atdheun e tij, si leitmotiv vijues mbikohor që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e Tij është një shembëlltyrë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, kor-

rekt, i shquar ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigand hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë. Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situatë të ndryshme pati dhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përlënë Gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptari që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare.

Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përballjes në gjyqe ushtarake, përballoi burgje e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua Heroit herë me tufa me lule herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime. Ai është një model i ardhur nga genocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja.

Mbi 20 vjet në krye të Shoqatës së Veteranëve të Luftës, me ndershmëri dhe principe të larta morale ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave

dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike duke dhënë edhe në moshë pensioni, një ndihmesë të vyer në emancipimin politiko-shoqëror e demokratik të shoqërisë. Si një lundëtar i shquar ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqëta të demokracisë që po jetojmë. Jo vetëm gjatësia kohore e jetës por dendësia dhe përmbushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bën këtë figurë të lartësohet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e Tij dëgjohej deri në organizata famoze ndërkombëtare.

Në këtë vështrim Gjeneral Rrahman Parllaku përmban një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar.

Marrë nga gazeta “PANORAMA”, datë 24.09.2019

INTERVISTA E FUNDIT

“Skenari i zi”, Si u fuqizua Enver Hoxha nga jugosllavët, plani për bashkim me Titon Sekretar të Parë

PARLLAKU: Merita e Fadil Hoxhës është se nuk lejoi shpërbërjen e Kosovës

Aristir Lumezi

Frika për një puç ushtarak duket se e ka shtyrë Enver Hoxhën që të sulmojë drejtuesit e lartë të Ushtrisë. Duke dënuar ata, Enver Hoxha dobësonte pozitën e forta që Mehmet Shehu kishte në Ushtri, ku në Shtabin e Përgjithshëm kishte emëruar 7 komandantë dhe gjeneralë të Brigadës së parë.

Jugosllavët ishin ata që e mbështetën Enver Hoxhën që të merrte fuqinë e plotë në krye të PPSH-së dhe pse në Pleniumin e Beratit, ai kishte marrë kritika të forta. Në vijim të rrëfimit të tij, gjeneral lutenant, Rahman Parllaku, tregon se në mënyrë të përsëritur, Enver Hoxha ishte shprehur për t'iu bashkangjitur federatës jugosllave, duke pranuar Titon si Sekretar të parë të Partisë dhe ai vetë me Koçi Xoxen të ishin sekretarë të një prej republikave të federatës.

Gjatë gjithë këtyre viteve të demokracisë shqiptare nuk kanë munguar tezat se PKSH u formua nga jugosllavët dhe të dërguarit e Titos, Miladin Popović dhe Dushan Mugosha. Ju keni qenë pjesë e strukturave drejtuese, çfarë roli kanë patur jugosllavët?

Për hir të së vërtetës, nuk kam qenë në grupet komuniste dhe as i ndikuar nga ata, por kam mësuar se në mbledhje, nisimat për krijimin e PKSH ka qenë e grupeve komuniste, grupi i Korçës, i Shkodrës dhe i të Rinjve. Ka qenë grupi i Zjarrit që nuk u përfshi në krijimin e partisë. Këto grupe morën iniciativën për të krijuar PKSH. Në mbledhje ka qenë Miladin Popović dhe Dushan Mugosha. Unë me Dushanin jam njohur gjatë viteve 1943, se kam qenë në Vlorë. Me Miladinin, jam njohur fillimisht në Shtabin e Përgjithshëm në Elbasan. Kur kalova në Kosovë me formacionet tona, me Miladinin u takuam dhe u miqësova se më pritë shumë mirë. Komanda e Brigadës u thirr nga Komanda e korpamatës së Parë në Priskë të Tiranës dhe na njoftoi Urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm për kalimin në Kosovë të brigadave 3 dhe 5 me këto detyra:

1-Të ndihmonim në çlirimin e Kosovës nga pushtuesit nazistë

2-Të nxisnim kosovarët të merrnin pjesë masivisht në luftë kundër nazistëve gjermanë, që të shkëputeshin nga boshti fashist dhe t'i bashkoheshin Aleancës antifashiste të popujve, se vetëm kështu linte e drejta për vetëvendosje pas luftës

3-Të godisnim forcat e grup-armatës ERE që po tërhiqej nga Greqia e Maqedonia, për të shkuar në Frontin e Perëndimor kundër Aleatëve.

4- Të këshillonim kosovarët të merrnin pjesë masivisht në ngritjen e pushtetit popullor, si shumicë e popullsisë që ishte. Në plotësimin e këtyre detyrave, për fat të keq u përballëm jo vetëm me forcat gjermane, por edhe ato mercenarëve që ishin vënë në shërbim të nazistëve, Divizioni SS Skënderbej, Regjimenti Kosova dhe Xhandarmëria, si formacione që siguronin rrugët nga Greqia dhe Maqedonia për tërheqjen e forcave naziste në Kaçanik, Prizren, Kukëz, Gjakovë, Pejë e Rugovë.

Sa ndikoi Brigada e 3 dhe 5 në kthimin e formacioneve kosovare, pra aleancës?

Para se t'i përgjigjem pyetjes suaj, dua të sqaroj se kosovarët pushtimin fashist e cilësuan çlirim, çlirim nga shtypja serbe. Pushtuesit fashistë e



bashkuan Kosovën me Shqipërinë, hapi shkolla shqipe, u dha pushtetin, u krijuan prefekturat shqiptare, u larguan shumë familje serbe që ishin vendosur në Kosovë në tokat e tyre.

Dhe kjo në fakt ishte çlirim, krahasuar me shtypjen serbe. Kur erdhën gjermanët, pas kapitullimit të Italisë fashiste, ata shpallën pavarësinë e Shqipërisë dhe thanë se jemi kalimtarë. Kosovës iu bashkuan dhe Prefektura e Mitrovicës me krahinat e Vuçiternës e Podujevës, të cilat gjatë pushtimit, gjermanët i kishin mbajtur të varura nga Beogradi, për minierat e Trepçës.

Kështu që kosovarët e kishin të pamundur të bashkoheshin me serbët për të luftuar fashizmin. Fashizmi gjeti mbështetje dhe organizoi formacione luftarake me kosovarë. Kur shkuan brigadat tona në Kosovë, atje vepronin Divizioni SS Skanderbej, një divizion shqiptar, i cili ishte rreshtuar në krah të gjermanëve dhe Hitleri u kishte dhënë gradën SS, të gardës, pra u kishte dhënë pushtet.

Kishte krijuar Regjimentin Kosova që bëri krime edhe në Shqipëri më 4 shkurt në Tiranë dhe krime në Shkodër, kishte krijuar xhandarmërinë, pra një forcë ushtarake solide për të mos lejuar serbët që ta rimerrnin përsëri.

Kjo ishte në shërbim të gjermanëve. Më 18 tetor, mora urdhër të shkoj në ndihmë të Brigadës së Pestë që luftonte për çlirimin e Gjakovës. Me mua në brigadën e tretë ishte dhe Manush Myftiu, i deleguari i Korpamatës për brigadën e 3 dhe të 5.

Kaluan në Kosovë, ndërkohë që Brigada e 5 ishte tërhequr nga luftimet e Gjakovës, sepse ishte sulmuar nga Prizreni dhe Peja, e kishte rrezik të rrethohej. Qëndruam në periferi të Gjakovës dhe morëm kontakt me Brigadën e Parë të Kosovës. Manushi kishte detyrë të takonte Gani Kryeziun, i cili me çetën e tij ishte në Devë të Gjakovës. Shkuam e takuam Ganiun të nesërme e hyrjes në Kosovë. Manushi i kërkoi Ganiut në emër të Shtabit të Përgjithshëm që të dorëzonte forcat e tij të divizionit ynë. Telegrami i Enverit ishte që të vepronim me Gani

Kryeziun si me Muharrem Bajraktarin.

Ishte Fadil Hoxha që u fut në mes të forcave tona dhe Gani Kryeziut, se përndryshe do të kishim një vëllavrasje. Ne arritëm që t'i përfshinim kosovarët në luftë kundër pushtuesit. Duke marrë pjesë masivisht në luftë, gjatë të cilave vetëm nga Brigada 3 pati 42 të vrarë dhe 64 të plagosur, në mes tyre isha dhe unë. Me gjithë këto humbje, partizanët u sollën në mënyrë vëllazërore me popullin. Në Junik, na u vranë 32 partizanë nga mercenarët dhe ne zumë 27 prej tyre robër, por nuk i pushkatuam. Prandaj me krijimin e Divizionit të Pestë mbi 1600 kosovarë iu bashkuan vullnetarisht dhe ne i trajtuam si partizanët e vjetër.

Por luftimet në Kosovë kanë qenë të ashpra për çlirimin e rrafshit të Dukagjinit, Prizrenit, Gjakovës e Pejës. Në veçanti ato në Junik, Deçan e Pejë, gjatë të cilave vetëm nga Brigada 3 pati 42 të vrarë dhe 64 të plagosur, në mes tyre isha dhe unë. Me gjithë këto humbje, partizanët u sollën në mënyrë vëllazërore me popullin. Në Junik, na u vranë 32 partizanë nga mercenarët dhe ne zumë 27 prej tyre robër, por nuk i pushkatuam. Prandaj me krijimin e Divizionit të Pestë mbi 1600 kosovarë iu bashkuan vullnetarisht dhe ne i trajtuam si partizanët e vjetër.

Kështu që kosovarët e kishin të pamundur të bashkoheshin me serbët për të luftuar fashizmin. Fashizmi gjeti mbështetje dhe organizoi formacione luftarake me kosovarë. Kur shkuan brigadat tona në Kosovë, atje vepronin Divizioni SS Skanderbej, një divizion shqiptar, i cili ishte rreshtuar në krah të gjermanëve dhe Hitleri u kishte dhënë gradën SS, të gardës, pra u kishte dhënë pushtet.

Cili ka qenë roli i Fadil Hoxhës në këtë luftë?

Për mua, Fadil Hoxha është më i madhi i të gjithë shqiptarëve, qofshin në Shqipëri apo në Kosovë. Më i madhi duhet të ishte Enveri, po të mos kishte pushkatuar të vetët si Pol Poti. Fadil Hoxha ka meritën se e krijoi atë Ushtri, e udhëhoqi, e la Kosovën të banuar nga njerëzit. Nuk fitoi atë që kishte vendosur Konferenca e Bujanit, e vetmja konferencë kombëtare që i jep të drejtën Kosovës për vetëvendosje dhe atë e realizoi UÇK-ja. Turqit nuk vendosën kufij etnikë, sepse nuk e njihnin Shqipërinë, kur erdhën fashistët nuk vendosën kufij se Mitrovica ishte pjesë e Serbisë.

Kufijtë etnikë i ka caktuar Kushtetuta e 1973 e Jugosllavisë, e cila i caktoi kufij Krahinës Autonome. Fadil Hoxha nuk e la Mitrovicën me Beogradin, siç e kishin lënë pushtuesit, por vendosi dhe dy komuna serbe nga sipër që Trepça të ishte e Kosovës dhe jo e Serbisë.

Këtë mund ta bënte vetëm Fadil Hoxha dhe ekipi i tij udhëheqës me ndikimin që kishte tek Titua. Titoja

nuk e bënte për Fadilin këtë, ai e bëri për vete. Sepse ishte kundër shovinizmit serb. Pasi rrëzoi Rankoviçin, kroatët ishin kundër serbëve, boshnjakët ishin kundër serbëve, atëherë dhe shqiptarët bëheshin kundër serbëve e në këtë mënyrë bënte balancimin e forcave kundër serbëve.

U ul fuqia e serbëve dhe kështu Titoja krijoi barazinë e kombeve të Jugosllavisë. Titoja nuk e quajti Republika e Kosovës, sepse as Enveri nuk e donte, se kishte frikën se Republika e Kosovës do të zbriste edhe më në jug, tërhiqte dhe Shqipërinë. Titoja e la krahinë Autonome, e cila kishte qeverinë e vet, Policinë e vet, Ushtrinë e vet, gjykatat e veta. Po të studiosh Kushtetutën e Jugosllavisë, shihet qartë se Kushtetuta e Kosovës nuk mund të zhbëhet pa vendimin e Kuvendit të Kosovës. Veç kësaj, Kushtetuta e federatës së Jugosllavisë, nuk mund të ndryshohej pa vendimin e kuvendit të Kosovës.

6 republika dhe 2 krahina autonome ishin të barabarta për federatën jugosllave. Gjatë udhëheqjes së Fadil Hoxhës dhe ekipit të tij, u hapën Universiteti i Kosovës, Biblioteka kombëtare, Instituti i albanologjisë etj. Merita e Fadil Hoxhës është se nuk lejoi shpërbërjen e Kosovës, ruajti gjuhën, kulturën, vendosi kufijtë e Kosovës, kufij të cilët nëse prishen, prishet i gjithë Ballkani. Ky është Fadil Hoxha. Le të thonë ç'të duan për të. Erdhi Fadil Hoxha në Tiranë më 1947, u takua me Enver Hoxhën për të marrë libra për shkollat. E pyet Enveri, si është gjendja në Kosovë? 'Serbët, po sillen më keq se Karageorgjeviçi', tha Fadili.

Kjo deklaratë e Fadilit shkoi në Kosovë të serbët para se të shkonte Fadili atje. Sepse kur shkoi në Kosovë, e thirrën në Komitetin e Partisë dhe i kërkuan llogari pse ishte shprehur ashtu. U akuzua Koçi Xoxe, por Enveri ishte më i lidhur me jugosllavët, sepse Fadili kishte takuar vetëm Enverin. Këta që akuzojnë Fadilin e shitën Kosovën. Sa herë shkoi Enveri në Jugosllavi, shkoi dhe në Vojvodinë, por asnjëherë në Kosovë. Sepse nuk kishte çfarë përgjigje t'u jepte kosovarëve. Kur mora urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm që të emërohesha komandant i Divizionit të 5, më 22 nëntor 1944, urdhërohesha që në përbërje të kisha brigadën e 3, 5 dhe të 25 të Malësisë së Gjakovës, të përqendroja forcat në rajonin e Mitrovicës, Vuçiternit dhe Skënderajt.

Urdhrin e parë si Komandant Divizioni e kam bërë kur marshonim diku afër Istogut, njoftoja Shtabin e Përgjithshëm se si po lëviznim brigadat e divizionit tim dhe kisha marrë urdhër që të takohesha me komandantin e divizionit 22 jugosllav.

Shkova në Mitrovicë, shtabi ishte vendosur në zyrat e Prefekturës së Mitrovicës. Aty gjeta një gjeneral rus, dy kolonellë të gjithë me grada ushtarake, unë isha i veshur keq e më keq, me opinga. Takova komandantin dhe i thashë që të bashkëpunonim për të bashkërenduar forcat dhe veprimet. Të tjerët mbetën indiferentë nga vajtja ime.

Në dhomë vjen Miladin Popović, më takoi me përzemërsi. Nga ai moment aty situata ndryshoi krejtësisht, patëm më shumë vlerësim. Këtu u njoha më shumë me Miladinin. Ai u interesua se çfarë po ndodh në Shqipëri, unë i thashë se nuk kam informacion, por jemi çliruar.

75-VJETORI

Pas ngritjes së Shtabit Operativ për çlirimin e Korçës, Brigada IX-të kishte në përbërje të saj 1580 partizanë

75 vjet më parë - Brigada e IX-të S luftoi heroikisht për çlirimin e Korçës

Brigada IX-të Sulmuese u formua në katundin Lozhan të Gorës, qarku i Korçës, më 16 tetor 1944. Shtabi i brigadës ishte i përbërë nga Irakli Bozo, komandant; Mihallaq Zicishti, komisar; Petro Papi; zv/komisar; Meleq Babani, përgjegjës rinie dhe Vangjel Marko intendent.

Kjo brigadë u krijua me qëllimin e shtimit të veprimeve ushtarake në zonën e Korçës. Detyra ishte të eliminonte autokolonat armike që lëviznin në aksin Janinë-Korçë-Manastir-Follorinë, Korçë-Pogradec-Tiranë, por detyra më e rëndësishme ishte çlirimi i qyteteve të Korçës, Ersekës dhe Bilishtit. Me marrjen e këtyre qyteteve armikut i pritëshin rrugët e komunikacionit dhe paralizohej tërheqja e ushtrisë gjermane nga Greqia për në Jugosllavi nëpërmjet territori shqiptar.

Urdhri për krijimin e brigadës u dha nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në përbërje të tij u caktuan batalione me përvojë në luftë kundër pushtuesve. Inaugurimi i brigadës u bë para efektivit të saj ku u rreshtuan të gjithë batalionet e saj. Brigada kishte një armatim që dispononte e gjithë ushtria shqiptare në atë moment, ajo kishte armë të dhuruara nga populli, por edhe nga ndihmat aleate të hedhura me parashutë, si armë automatike, por që nuk plotësonin të gjithë numrin e pjesëtarëve të brigadës. Brigada ishte e pajisur me shërbim shëndetësor. Pranë shtabit të brigadës qëndronte një mjek dhe 2-3 infermiere vullnetare.

Pas ngritjes së Shtabit Operativ për çlirimin e Korçës, Brigada IX, që përbënte dhe një nga forcat kryesore pjesëmarrëse në operacion, kishte në përbërje të saj 1580 partizanë. E gjithë forca partizane në zonën e Korçës arrinte në 3000 veta, po të shtohen këtu edhe partizanët e Brigadës II me 1150, dhe brigada e XX-të me 430. Këtu mund të shtojmë edhe forcat guerile që vepronin brenda në qytete, si në Korçë dhe Bilisht, të cilat arrinin në rreth 1000 vetë.

Forcat armike që kontrollonin zonën e Korçës ishin më të pakta në numër, por të pajisura dhe mbështetura në tanke dhe artileri. Këto forca armike kishin nën kontroll vetëm rrugët kryesore dhe duhej të siguronin tërheqjen e forcave gjermane nga Greqia në Jugosllavi, e cila përbëhej nga Korparmata e 21.

Në bazë të urdhrave të Shtabit të Operacionit, batalionet e brigadës morën të gjithë detyra të ndryshme në zona të ndryshme në bashkëpunim me batalionet e brigadave ndihmëse. Batalioni I u caktua të asgjësonte garnizonin e Kolonjës dhe Leskovikut. Batalioni i II-të duhej të kontrollonte disa prej katundeve që kishin pranë rrugën automobilistike Qafë e Qarrit-Korçë. Batalioni III duhet të sulmonte garnizonin e Bilishtit dhe të kontrollonte kufirin në zonën e Kapshticës. Batalioni IV në bashkëpunim me batalionin e I të brigadës së II duhej të sulmonte garnizonin e qytetit të Korçës dhe çlirimin përfundimtar të qytetit. Disa prej tyre edhe u diktuan në momentin kur dhe do të zinin pozicionet e luftimit, ata u goditën nga zjarri i artilerisë armike. Katër batalionet e brigadës u vendosën sipas urdhrit në pozicionet e caktuara. Të parët që u ndeshën me forcat armike ishin partizanët e batalionit I, të cilët mundën të futeshin thellë në linjat armike.

Nga Janina po tërhiqej një autokolonë e madhe me gjermanë, të cilët rrugës do të mblidhnin edhe disa nga garnizonet që kishin në Leskovik, Korçë dhe Bilisht. Kjo autokolonë u sulmua nga batalioni I i Brigadës IX në bashkëpunim me batalionin II të Brigadës II. Lufta ishte e ashpër, me sulme e kundërsulme, por falë errë-



sirës, autokolona arriti të dalë nga rrethimi dhe të largohet në drejtim të Korçës. Ky largim i gjermanëve lejoi që forcat partizane të futën në qytetet e Leskovikut dhe Ersekës.

Në mesin e tetorit forcat partizane kishin nën kontroll të gjithë krahinën e Kolonjës, në dorë të tyre kishin rënë shumë materiale ushtarake të lëna nga armiku në ikje e sipër.

Të katër batalionet raportonin suksese në zonat ku ishin caktuar. Ato filluan sulmin kundër forcave gjermane që gjendeshin të pozicionuara jashtë Korçës, duke pasur sukses dhe duke shkaktuar panik midis armikut. Kjo bëri që ato të tërhiqeshin në mënyrë të çrregullt drejt Korçës. Batalioni i katërt tentoi me sukses edhe bllokimin e rrugës Korçë-Pogradec, kjo i detyroi forcat naziste të mos kishin asnjë komunikim me forcat jashtë, duke shuar edhe shpresën për ndonjë ndihmë të mundshme. Ky ishte një sukses në fushën e betejës për dy brigadat që organizuan sulmin. Sukses ishte edhe për komandën e brigadës, e cila kishte vetëm pak kohë që ishte krijuar.

Në bashkëpunim me Brigadën II, Brigada IX iu afrua lagjeve të jashtme të Korçës. Menjëherë mbi qytet filluan sulme të organizuar me qëllim shqetësimin e armikut. Duke e zgjatur vijën e luftës, partizanët po ngushtonin rrethimin e armikut. Të gjendur në dëshpërim gjermanët tentonin të tërhiqeshin prapa, andej nga kishin ardhur, nga kufiri grek. Forcat zbuluese partizane mundën të lokalizojnë saktësisht vendosjen e armikut dhe mënyrën se si mbroheshin. E gjithë kjo u arrit në bashkëpunim me forcat guerile që ndodheshin në qytet. U dha urdhër që rrethimi të ngushtohej edhe më shumë, forcat partizane intensifikuan sulmet, ato arritën deri në pazarin e qytetit, duke u ndeshur dhe trup me trup me gjermanët.

Kjo i detyroi gjermanët që ta përqëndronin çarjen e rrethimit në një pikë, verilindjen. U përdorën të gjitha armët e mundshme, që nga artileria dhe autobлиндat. Ata filluan të hidhnin në erë shumë pika strategjike të qytetit, por sidomos edhe depon e municioneve shpërthimi i së cilës shkaktoi një gjendje alarmi. Gjermanët kishin lënë vetëm një shteg për t'u tërhequr, shteg, i cili u bllokua menjëherë nga forcat partizane. Vetëm një pjesë e tyre mundi të shpëtojë dhe të largohet nga qyteti. Pjesa tjetër u vra ose u kap rob nga partizanët. Ky ishte edhe sulmi i fundit i partizanëve, të cilët mundën ta çlironin përfundimisht qytetin e Korçës. Mbetej të bëhej edhe

jekjesh partizanët i detyruan gjermanët të tërhiqeshin nga pozicionet e zjarrit dhe të strukeshin në kazermat e qytetit. I gjithë sulmi vazhdoi tërë natën e 25 tetorit duke i bërë gjermanët të tërhiqeshin drejt kufirit grek.

Edhe pse dolën nga kufiri shqiptar gjermanët u ndoqën dhe u sulmuan duke u shpartalluar përfundimisht. Partizanët e Brigadës IX u futën dhe ndihmuan popullin grek nga forcat gjermane, në katundet Drenovon. Operacionet për çlirimin e Korçës u kryen në një kohë të shpejtë. Kjo ishte rezultat i bashkëveprimit me batalionet e tjera të Brigadës II. Populli i Korçës iu rezervoi një pritje të madhe partizanëve kur këta u futën në qytet për nder të tyre u organizuan koncerte e festime. Populli i Korçës doli i gjithi nëpër rrugë dhe festoi me partizanët çlirimin e qytetit. Kori i qytetit për nder të kësaj ngjarjeje këndoi këngë patriotike, sidomos një këngë e cila ishte përgatitur posaçërisht për këtë ditë.

Por shfaqje të tilla gëzimi kishte edhe në qytetet e tjera si Bilishti dhe gjithë qarkun e Korçës, të cilat zgjatën tërë natën deri në mëngjes.

Menjëherë pas çlirimit të qarkut të Korçës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, dy nga batalionet e brigadës IX u vendosën në mbrojtje të qytetit të Korçës dhe dy të tjerë në mbrojtje të qytetit të Bilishtit. Detyrë ishte edhe mbrojtja e kufirit me Greqinë, e cila po mbante një qëndrim agresiv ndaj popullit shqiptar sidomos çamëve. Pas qetësimit të gjendjes forcat e Brigadës IX, që tashmë kishin hyrë në përbërje të Divizionit të IV, morën urdhër të largohen nga qarku i Korçës dhe të vendosen në Shqipërinë e Mesme në rajoni Krujë-Ishëm-Kavajë

KRONIKË E NGJARJEVE TË RËNDËSISHME HISTORIKE PËR MUAJIN TETOR

- 4 tetor 1944 - U formua në Bicaj të Lumës Brigada e XXIV-të S. e U.N.ÇL.SH.
- 4 tetor 1937 - Ka rënë në Spanjë Heroi i Popullit Asim Vokshi, komandanti i batalionit të III i Brigadës Internacionaliste "Garibaldi".
- 9 tetor 1943 - U formua në Pezë Brigada e III-të S. e UNÇLISH
- 7 tetor 1942 - Ra heroikisht duke lufuar në rrethim me fashistët, komandanti i njësiteve guerile të Tiranës, Heroi i Popullit Vojo Kushi, bashkë me shokët e tij Xhorxh Martini dhe Sadik Stavaleci, në shtëpinë e qytetares Ije Farka.
- 10 tetor 1943 - U formua Batalioni i Pezës.
- 10 tetor 1943 - U formua Batalioni "Antonio Gramshi" i përbërë prej 170 vullnetarësh proletarë italianë. Nga ky batalion ranë dëshmorë 15 partizanë, kurse 24 të tjerë u plagosën.
- 10 tetor 1944 - U formua Divizioni i III-të S. i U.N.ÇL.SH., i përbërë nga Brigada 12-të, 14-të dhe e 19-të S.
- 11 tetor 1925 - Lindi në Tiranë Heroi i Popullit Myslim Keta.
- 11 tetor 1944 - U çlirua qyteti i Sarandës prej Brigadës 12-të e 14-të S.
- 13 tetor 1944 - Brigada e III-të dhe e V-të Sulmuese të U.N.ÇL.SH. kaluan kufirin për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit fashistë.
- 15 tetor 1944 - U çlirua qyteti i Vlorës prej partizanëve të Brigadës 12-të Sulmuese.
- 16 tetor 1944 - U formua në Lozhan të Korçës Brigada e IX-të Sulmuese e U.N.ÇL.SH., prej batalionev "Fuat Babani", "Reshit Çollaku", "Skënder Çaçi", "Tomorri" dhe "Hakmarja".
- 17 tetor 1944 - U çlirua qyteti i Kuçovës prej Brigadës VIII dhe XVI Sulmuese.
- 18 tetor 1943 - U qëllua me top pallati ku ishte mbledhur Asambleja Kuislinge, që do të legalizonte pushtimin e ri të Shqipërisë nga nazistët gjermanë, e cila shënon edhe ditën e armës së Artilerisë së Ushtrisë Shqiptare.
- 20 tetor 1942 - U formua çeta e Kolonjës.
- 20 tetor 1944 - U bë mbledhja e II-të e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar.
- 24 tetor 1944 - U çlirua qyteti i Korçës.
- 28 tetor 1940 - Italia fashiste sulmoi Greqinë.
- 28 tetor 1941 - Demonstratë e madhe antifashiste në Tiranë.
- 28 tetor 1941 - Demonstratë e madhe antifashiste në Tiranë.

Përgatiti: Ing. Myfit GUXOLLI
Nënkryetar i OBVL

STUDIMI

78 vjet më parë - Qëndresa heroike në Kodër të Kacës

Si u mposht ekspedita fashiste e Xhafer Balit nga malësorët trima të Reç e Dardhës



Nga Dine KACA

BESELIDHJA E QËNDRESËS ANTI-FASHISTE

Pas disfatës në Dibër të Madhe me forcat kryengritëse të drejtuar nga luftëtari trim e i paepur Haxhi Lleshi, ajo që e shqetësonte më shumë fashizmin do të qe se dibranët mbanin armë të fshehura dhe se një ditë Dibra, do të mund të ngrihej në luftë të armatosur kundër fashistëve dhe bashkëpuntorëve të tyre, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Prandaj në vazhdim të masave ndëshkimore, fashizmi do të organizonte ekspedita operationale në të gjithë Dibrën për dorëzimin nga dibranët të armëve të fshehta dhe municioneve. Kjo u diktua edhe nga qëndrimi që mbajtën shqiptarët në luftë kundër agresionit fashist që ndërromori Italia ndaj popullit grek në 1940-tën. Ekspeditat kryen operatione në të gjithë krahinat e Dibrës, ndërsa krahinat Reç e Dardhë, qenë lënë për në fund. Gjatë operationeve, pati rezistencë të fortë, por gjithësesi ato kishin mundur të grumbullonin një sasi të vogël armësh e municionesh.

Në strategjinë e taktikën fashiste, jo pa qëllim ishin lënë për në fund krahinat Dardhë e Reç. Kjo për faktin historik se ato njiheshin si krahina të lidhura shumë ngushtësisht njëra me tjetrën dhe se bijtë e tyre qenë shquar për trimëri e atdhetarizëm. Ata patën dhënë prova të forta kundër pushtuesve, çka e vështirësonte së tepërmi çarmatimin e tyre. E kjo qe bërë mos represioni do të ndikonte që edhe Reç e Dardhë t'i nënshtroheshin këtij operationi. Fashizmi nuk kishte nevojë për armë, por donte të shuante ç'do vatër e lidhje patriotike që përbënin rrezik për të.

Termi "çarmatosje" tingëllonte shumë rëndë në veshin, psikologjinë dhe mentalitetin e popullit të Reç e Dardhës. Nëse do të ndodhte kjo, do të ishte për ta poshtërim i madh, do t'a quanin veten se nuk ishin më askush. Edhe para fashizmit, pushtues të tjerë që nga turqit osmanë, bullgarë, austro-hungarez e të tjerë, apo regjime antipopullore, nuk kanë mundur as t'i çarmatosin dhe as t'i nënshtrojnë. Arma në duart e tyre ishte gjithshka. Historikisht, lufrat e njëpasnjëshme, ua kishin imponuar që ta konsideronin armën pjesë të jetës, të qënies së tyre. Me armën ata patën lidhur jetën e tyre, mbronin familjen, dinjitetin, nderin, lirinë, atdheun për të cilin nuk kursenin as jetën.

Ata kishin një përvojë shumë të pasur, të trashëguar brez pas brezi, pavarësisht se në të gjitha lufrat e betejat me armiqtë pushtues, në raportin e forcave, ata kishin qenë në pakicë, por shpirti lirishtashës e luftarak, atdhetarizmi, optimizmi dhe vendosmëria i bënin superiorë. Kurdoherë fitorja ishte në anën e

tyre. Edhe ky ishte një faktor që i bënte këto dy krahina të ishin të vendosura në qëndresë me ekspeditën ushtarake fashiste për çarmatimin dhe e kishin të sigurtë fitoren ndaj saj.

Krahinat Dardhë e Reç të Dibrës, gjithmonë kanë vepruar me organizmat e zgjedhura nga vet populli. Ato kishin detyra e të drejta komplekse, për të gjithë jetën e krahinës, ku më kryesorja ishte ajo e mbrojtjes së atdheut. Kështu, krahina e Dardhës drejtohej nga të "15-tët e dheut" ose siç mund të quhet një "Kuvend - Parmament" i Dardhës me përfaqësues të denjë me integritet, si: Hysen Ndreu, Hysni Kaca, Hysen Bara, Hysen Çera, Misim Ahmeti (Cerpja), Rrahman Rasha, Ahmet Kazi, Vesel Sula, Muharrem Hoxha, Taf Shira, Ali Bajram Ndreu, Sul Cani, Met Kaca, Selim Hysa e Can Gjoka. Më vonë për arsye vdekje, janë zgjedhur të tjerë nga populli si, Xhetan Hakiku, Haziz Poleshi, Mehdi Kaca e Sadik Çera. Një organizëm të ngjashëm drejtimi me Dardhën kishte edhe krahina e Reçit, por jo me kuvend, por me pleq.

Të dyja këto organizma të këtyre krahinave kishin përcaktuar pikat e beselidhjes të qëndresës antifashiste. Debatimi dhe marrja e vendimit qe bërë në bazë fisi, fshati e krahine me moton "besa-besë".

Përfundimisht u vendos:

Së pari, në përballjen me ekspeditën u caktua nga një burrë për shtëpi, (aty ku kishte disa burra në disa shtëpi, të vinin dy edhe tre), kryesisht të moshuar, të sprovuar në luftë dhe ky organizëm ishte konsideruar si skalion i parë. Burrat e tjerë dhe moshat e reja, do të qëndronin të gatshëm në rast nevojë si skalion i dytë për luftë të armatosur frontale.

Së dyti pjesmarrësit e të dy krahinave do të grumbulloheshin në mënyrë të organizuar në Kodër të Kacës të Dardhës.

Së treti, asnjë armë nuk do t'i dorëzohej pushtuesit. Kur pushtuesit do të kërkonin dorëzimin e armëve, fillimisht pjesmarrësit do të heshtnin deri në kulmin e durimit.

Së katërti, në momentin që do të shanin apo do të përdornin forcën, do të hidheshin në sulm deri trup me trup për ta çarmatosur të gjithë ekspeditën. Nëse do të qëllonin me armë e do të kërkonin forca ushtarake shtesë për të shtypur popullin me dhunë, do të nxirreshin armët dhe do të ngriheshin në "shtatë e shtatëdhjetë" në luftë kundër pushtuesit fashist.

Kjo përgaditje nuk u bë brenda një apo dy e tre ditësh. Jo. Kishte kohë që punohej për këtë. Unë dhe moshatarët e mij i kujtojmë me hollësi, se si baballarët dhe gjyshërit tanë na patën përgatitur për çdo lloj situatë. Ata kanë një meritë të veçantë ndaj brezit tonë. Armet dhe municionet e fshehta, ashtu siç dinin vetë t'i përdornin, na i kishin mësuar edhe ne të rinjve. Jo vetëm si mbahet, si përdoret, si merret vija e shënimit për të godit me plumbin e parë në shenjë, por edhe si mund të ndeshesh trup me trup dhe t'i marrish edhe armën armikut, e shumë gjëra të tjera. Kishte gati dy muaji që Reç e Dardhë bënin përgatitje. Sa do të kalojnë vitet, edhe pse tani jemi në ekstremet e moshës, i kujtoj me nostalgji, me respekt, me shumë dashuri dhe u jemi mirënjohës atyre burrave trima, atyre "tigrave" të asaj kohe. Ata na brumosën me vërtetë me të larta dhe ndjenjën e dashurisë për atdheun tonë, Shqipërinë.

8 SHTATOR 1941 - QËNDRESA E "TIGRAVE" TË REÇ E DARDHËS PËR TË MOS DORËZUAR ARMËT

Sapo zbardhi drita, fshatarët e fshatrave të largëta të Reçit filluan lëvizjen drejt Kodrës së Kacës të Dardhës. Të parët ishin burrat e fisit Doda në Tejmalë, në kufi me Arnin e Kukësit, të fiseve Laçi, Gjurma, Poga ne Gjurre-Rec; Lusha, Leka, Sinani, Laçi, Doda, Toshi, Lala e Troci në Ndërshenë e Hurdhë - Reç; Shehu, Cara,



Prenci e Hasani në Bardhaj - Reç; Troci, Leka, Tanushi, Lala, Meçi, Murati, Elezi e Uklala në Thark e Zall-Reç; Troci, Kuçi, Doda, Peca, Shoti, Çajka, Prenci, Halili dhe Hasani Draç-Reç; Koka, Marku, Mziu, Vladi, Tafa, Lami, Skeja, Sufa, Hysenaj, Bardholi e Shehu në Kraj-Reç.

Aty nga ora 9.00 rreshtat e burrave të krahinës së Reçit u futën në teritorin e Dardhës, në tre drejtime kryesore: Lashkizë - Tartaj - Kodër e Kacës, Soricë - Merskanë - Tartaj - Kodër e Kacës dhe Shënllëshën - Zall Dardhë - Lugje - Kodër e Kacës. Në këtë kohë krahina e Dardhës ishte gati në pritje të vëllezërve reçjanë, me të cilët u bashkuan, sipas fiseve: Cerpja, Hysa, Rasha, Topuzi, Ndreu, Cani, Poleshi e Hoxha në Lashkizë, Soricë e Merskanë; Kaca, Çera, Xhediku, Çajkri, Luca, Bara, Xhaferi, Demiri, Braka në Tartaj e Nezhë; Kazia, Cani, Sula, Murati, Ndreu, Hoxha, Shira, Rama, Çerpja, Hysa, Bara, Gjoka, Dervishi, Pira, Luca, Cala, Topuzi e Lushi në Shënllëshën, Zall Dardhë e Lugje të Dardhës.

Kodra e Kacës ku do të mbledheshin "Tigrat e Maleve" të Reç e Dardhës ishte vendi më strategjik. Njerëzit që patën mbetur nëpër shtëpia, ishin në ankth. Ata qëndronin në gadishmëri. Shumë domethënës ishte momenti kur takohen reçjanët me dardhianët, shtrëngimi i duarve, besa e lidhur, vendimi i marrë, i bënte ata të ecnin me kokën lart pa iu dridhur çerpiku.

Burrat e këtyre anëve kur shkonin në kuvende për betejat me armikun, visheshin me rrobat më të mira. Nën, gratë e motrat e tyre i kishin përgatitur me kostumet më të bukura kombëtare të krahinës. Që nga opingat me gjalma të bardha, çorape të qëndisur, tyrqe me gajtana, këmbisha të bardha me mëngë të lëshuara, breza leshi të thurur me larmi ngjyrash, xhamadana të llojeve të ndryshme e me gajtana, plise të bardha (qeleshe të bardhë) e deri tek sumullat e xhamadanave e çistekët e sahateve që xixëllonin nga rrezet e diellit e që krijonin shije artistike mahnitëse dhe të dukej sikur ata ishin me të vërtetë krushqit e një dasme madhështore.

Me këtë veshje karakteristike të krahinave i jepnin të kuptonte ekspeditës fashiste dhe Major Balit që e komandonte atë se: "ne jemi një popull me kulturë, kemi personalitetin e dinjitetin tonë, se dijmë të vishemi, dijmë të flasim, dijmë shumë mirë të njohim mikun dhe armikun..., dijmë të luftojmë e të mbrohemi..., se kemi ardhë këtu me një mendim e betim të përbashkët: "O fitojmë dhe nuk dorëzojmë asnjë armë, O vdesim të gjithë". Vetëm një gjë na mungon sot: Ajo që kërkonin ju, "Malihëri". Atë e kemi lënë në shtëpi dhe kur- rë s'keni për ta marrë. Paçka se sot jemi të paarmatosur, ne dijmë të luftojmë edhe pa armë! Provojeni..."

Kodra e Kacës, në ora 10:00, qe mbushur me rreth 700 trima "Tigra", ulur pranë e pranë njëri - tjetrit. Në sytë e tyre lexohej karakteri burrëror, vendosmëria, besimi në fitoren e përballjes që pritej të ndodhte nga çasti në çast. Ekspedita ushtarake ishte dislokuar aty afër. Në momentin para se të fillonte të fliste,

komandanti fashist Xhafer Bali dha sinjal dhe ekspedita krijoi një kordon në formë rrethi, 15 metra larg nga vendi ku ishin ulur malësorët trima. Të gjithë vëzhgonin mënyrën e levizjes të ekspeditës dhe armatimet. Fiksonin në detaje se si mund t'i kapnin e t'u merrnin armët kur do të bëhej përleshja, vërenin se ku kishte gurë, gardhiqe për të marrë hunjtë e mjete të tjera të forta për të sulmuar ekspeditën.

Më pas edhe vetë komandanti i saj me suitën që e shoqëronte u pozicionua përballë gjigandëve. Major Bali qe befasuar kur të gjithë trimat e Dardhës e të Reçit gozhduan sytë tek ai dhe shoqëruesit e tij. Ai qe vënë përballë një force shkatërruese të papërballueshme.

Gjithësesi e kishte filluar fjalën duke ju dridhur zëri: "fashizmi është garantuesi i mbrojtjes tuaj, i qetësisë populke, i së ardhmes, prandaj nuk keni nevojë të mbani armë e municione. Ato do t'i dorezoni ...". Për disa minuta ai u përpoq t'iu mbushte mendjen dhe u drejtohej: "Hë, kush do të flasë!" Asnjë nuk e kishte marrë fjalën! Ata flisnin me gjuhën e trupit. Syte nuk ia kishin ndarë Xhaferi Bali. Me këtë qëndrim, ata i thonin: "mos u gënje se do t'ju dorëzojmë armë, mos guxo të përdorësh forcën".

Heshtje! Xhaferi Bali kishte filluar të acarohet, rriti disi tonet e të folurit urdhërues ushtarak. Ndërsa malësorëve po u ziente gjaku e urrëjtja nga brenda. Ata po e lexonin njëri - tjetrin në sy.

I pari ishte ngritur Can Gjoka nga Dardha: "Or zotni, ti na kërkon të dorëzojmë armët, por s'i t'ia bëjmë?! Ne nuk kemi armë dhe aty ku nuk ka s'ke se çfarë merr".

Unë. - kish thënë Bali - nuk kam ardhë këtu të dëgjoj fjalë boshe, por dua të dorëzoni armët".

Pastaj e kish marrë fjalën Sadik Doda nga Reci: "Ti more zotni, na kërkon armë? Por arma ka qenë shpirti e jeta jonë. Me ato kemi luftuar pushtuesit, por për fat të keq nuk i kemi. Po t'i kishim në dorë në këtë moment edhe ne do t'i kishim "dhënë" e me kaq ta mbyllim".

Xhaferi Bali, i acaruar u kishte thënë malësorëve se: "nuk largohemi prej këtej pa grumbulluar armët, mos hezitoni t'i dorëzoni ato, për ndryshe do të keni pa-sojal".

U ngrit Hysni Kaca nga Dardha: "O zotni major! Siç na shikon gjithë këta burra kemi ardhë këtu. Të gjithë sa jemi, kemi qenë të armatosur. Kemi luftuar kundër pushtuesve turq, serb, bullgarë, kundra nemces etj. Sa për ta ditur, edhe unë kam patur pushkë. Atë ma kishte dhuruar Elez Isufi në luftë. Ato i kemi dorëzuar. Ju jeni shqiptar e duhet të na kuptoni, paçka se ti je komandant i kesaj ushtrie të armatosur që na ke rrethuar. Mirë është të mos e zgjasim me këtë punë se s'kemi çfarë të të japim..."

Xhafer Bali që e kishte pa se nuk po bënin efekt kërcënimet, përdori një taktikë tjetër. Nga Çidhna pati marrë tre burra nën vërejtje, gjoja se ato kishin ngelur pa dorëzuar armët. Që të friksonte burrat e Reçit dhe të Dardhës dha sinjalin që të përdorej dhunë ndaj njerit prej tyre dhe të arrestohej Medi Kaca. Në kohën që u

FESTA

Veprimtaritë jubilarë do kulmojnë me konferencën shkencore: “Qarku i Gjirokastrës gjatë Luftës së Dytë Botërore”

U festua 76 - vjetori i çlirimit të Përmetit

Muharem Kamani

75-vjetori i çlirimit të Përmetit nga pushtuesit nazifashistë u festua madhërisht. Sheshi kryesor i qytetit “Abdyl Frashëri” dhe fasada e “Përmendores së Partizanit” ishin zbukuruar me flamuj, banderola, kurora dhe tufa me lule.

Festës i dhanë gjallëri këngët dhe marshet partizane. Pjesëmarrësit vizituan me interes ekspozitën fotografike me aspekte nga luftimet për çlirimin e Përmetit, vendosur te sheshi përpara përmendores.

Personalitetet e pranishme pranë përmendores vendosën kurora dhe tufa me lule. Nën tingujt e Himnit Kombëtar qëndruan 1 minutë heshtje për të nderuar sakrificat dhe gjakun e të rënëve në luftën për çlirimin e qytetit. Mes qytetarëve të shumtë ishin të pranishëm veteranët shekullorë Visho Jemini e Veiz Dervishi, pasardhës të veteranëve dhe të familjeve të dëshmorëve.

Nderuan me pjesmarjen e tyre Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, Astrit Aliaj dhe N\prefekti i Përmetit, EdvinTuci,



deputetja Mirela Kumbaro, Kryetarja e Bashkisë Përmet, Alma Hoxha, Kryetarja e N\ kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, Lindita Rova dhe Hodajn Selmani, Kryetarja e Këshillit të Bashkisë Anila Mihali etj.

Moderatorja e kësaj veprimtarie Aleksandra Doni ja dha fjalën përshëndetëse Prefektit të Gjirokastrës z. Astrit

Aliaj i cili midis të tjerash tha se kjo datë do kujtohet brez pas brezi si dita e revoltës së bashkuar të përmetarëve ndaj pushtuesve nazi-fashistë, që dha shpresë dhe besim që Përmeti të çlirohej nga pushtuesit.

Prefekti Aliaj vijoi më tej se “Ky vit përkon me 75-vjetorin e çlirimit të atdheut, ku në rang prefekturë janë për-

gatitur dhe planifikuar aktivitete me karakter historik e kulturor në kujtim të datave historike, të cilat do kulmojnë me konferencën shkencore: “Qarku i Gjirokastrës gjatë Luftës së Dytë Botërore”.

Pjesëmarrësit në këtë festë jubilarë të 75-vjetorit të çlirimit të Përmetit i përshëndeti gjithashtu kryebashkiakja Alma Hoxha e cila foli për rolin e Përmetit si një qëndër e rëndësishme e lëvizjes antifashiste dhe që nuk e ndali luftën në asnjë moment. Ajo evidencoi gjithashtu faktin që rrethi i Përmetit i dha luftës 185 dëshmorë dhe heronjtë e popullit Musa Fratari, Skënder Caci dhe Meleq Gosnishi.

Mes atmosferës festive përmetarët i përshëndeti në këtë ditë të shënuar edhe deputetja Mirela Kumbaro.

Për pjesëmarrësit, Qendra Kulturore dhe nxënësit e shkollës “Nonda Bulka” dhanë një concert muziko - letrar. Festa u mbyll nga Grupi i sazave të Qendrës Kulturore me kolazh këngësh partizane, të cilat i dhanë një atmosferë festive kësaj veprimtarie kushtuar 76 - vjetorit të çlirimit të Përmetit.

78 vjet më parë - Qëndresa heroike në Kodër të Kacës

bënë gati dhe filluan të zbatonin urdhërin e tij, ky qe momenti i duhur për t'i vënë shkëmbinë benzinatës dhe si si vetëtimë u degjua zëri i Mahmut Laçit nga Gjurr-Reçi: “Burra, me dorë t'i kapim?!”. Thirrja e tij ishte pasuar nga Rrahman Rasha e Halim Lika (Cani), Musa Gjoka e Vesel Sula, Riza Poleshi e Riza Ndreu, Dali Leka e Dali Lami, Bajram Lusha e Ahmet Cani, Selman Halili e Mer Troci, Isuf Dervishi e Halim Kaca i Kodres, etj.

Të 700 burrat, si vetëtimë qenë vërsulur me thirrjen: “besa-bese-burra-aaa ha ha ha”, oshtiu zëri i tyre i fuqishëm, duke rrokur ç'fare gjetën përpara: gurë, hunj, ftoçë, sopata e mjete të tjera të forta.

Në ndihmë të menjëhershme u erdhën burrat e tjerë të shtëpive të fisit Kaca që ishin shumë afër dhe të fisit Xhedi-ku e Çera, që u ofronin mjete të forta. Si tigrë u lëshuan mbi major Xhafer Balin, grupin që e shoqëronte dhe ekspeditën. Ai e pa se njeri i gjallë nuk do shpëtonte nga kjo forcë shpërthyes. I dha urdhër ekspeditës që të mos shkrehej asnjë armë e vetme dhe të tërhiqeshin me shpejtësi të rrufeshme për të dalë nga flakët e zjarrit përveçues.

Të goditur nga breshëritë e mjeteve të forta e deri në përleshje trup me trup, Xhafer Bali, i mbrojtur nga shoqëruarit dhe tërë ekspedita, u larguan si mos më keq. Trimat i ndoqën fashistët deri sa kaluan territorin e krahinës së Dardhës. Edhe nëpër fshatin Mustafaj të krahinës së Çidhnës nuk e ndalën vrullin. Ekspedita kaloi Drinin dhe mori rrugën për në Peshkopi.

PAS FITORES NDAJ XHAFAER BALIT U VENDOS ITIFAKU: TË EVITOHEN GRINDJET DHE HASMËRITË

Pas qëndresës, të gjithë malësorët u kthyen përsëri në vendin ku ishte zhvilluar përleshja. Aty u përcaktuan detyra të reja për çdo situatë të papritur. Unanimisht u vendos itifaku: Të evitohen grindjet dhe hasmëritë. Të 15-tët e Dardhës dhe Pleqtë e Reçit, do të siguronin informacionin e nevojshëm për përshkallëzimin e veprimeve të dhunës që mund të ndërmerre pushtuesi ndaj të krahinave si hakmarrje, ndaj kërkohej të viheshin menjëherë në dijeni që të organizoheshin sa më shpejt kundër tij.



Edhe njëherë ishte theksuar se duhej të ishin të gjithë të bashkuar, në një mendje, të vendosur se edhe me këtë pushtues do të ishin në luftë të vazhdueshme deri sa ta shpörnin e të çlironin atdheun.

Asnjë forcë ushtarake fashiste si dhe çdo forcë tjetër civile që bashkëpunonte me fashizmin, nga ajo ditë e në vazhdim, nuk do të lejohej të futej në territoret e Dardhës e të Reçit, qoftë edhe për rrugëtim.

Pas këtyre vendimeve dardhjanet i ftuan dhe i morën për drekë në shtëpitë e tyre të gjithë bashkëlufëtarët reçjanë. Sidomos ata të fshatrave: Tartaj, Lashkizë, Merskanë, Soricë morën kryesisht luftëtarët e Ndershenës, Gjurrë-Reçit e të Tejmallës, Hurdhë - Reçit, Tharkut. Ndërsa nfa fshatrat e tjera, Dardha, Shenlleshni, etj, morën luftëtarët e Draj - Reçit e të Zall-Reçit. Gjatë orëve të drekës, vetëm për qëndresën në Kodër të Kacës u bisedua dhe tregimet bëheshin me hollësi, ashtu siç u zhvilluan në fakt.

Demonstrimet e krahinave të Reç e Dardhës, dëshmojnë më së miri se këto dy male nga “Nëntë Malet” e Dibrës, kanë qenë, janë e do të mbeten të lidhura ngushtësisht, si dy vëllezër të vërtetë. Që kur janë formuar për herë të parë si dy krahina e deri në ditët e sotme, Reçi

e Dardha janë shquar në veprimtarinë e tyre si bashkëudhetare, bashkëudhëqese, bashkëorganizatore, bashkeluftetare, si dhe bashkëfitimtare, ndaj edhe kanë një histori të përbashkët.

Filozofia popullore i ka emërtuar ato, si: “rëra dhe gëlqerja” që asnjëra nuk ben pa tjetrën! Midis tyre asnjëherë nuk është shfaqur ndonjë grindje, konflikt apo ndarësi. Ato kanë ditur të bashkëjetojnë në harmoni kurdoherë dhe në çdo situatë, të ruajnë identitetin e vet, shpirtin atdhetar e luftarak që i ka karakterizuar kundër pushtuesve të huaj dhe që i ka bërë këto dy krahina unitare, të cilat janë konsideruar si një “ushtri e rregullt pa uniformë”, me një art të nivelit të lartë. Ndonëse Reç e Dardhë kanë qenë në vështirësi ekonomike, atyre kurdoherë u ka kënduar pushka kundër armiqve, u ka buzëqeshur mikpritja e bujaria, besa e trimëria për atdheun dhe për mikun.

Në vargun e rrugëtimeve që pati bërë në Shqipërinë e Veriut, Edith Durham, do të kalonte edhe në Lurë të Dibrës, në Mirditë e në disa zona të tjera. “Lura, - thoshte ajo- është bajraku kryesor i grupit të tmerrshëm të Dibrës, Tigrave të Dibrës...”

Masiviteti antifashist i të dy krahinave ishte një qëndresë e menduar me mençuri,

ri, me objektiva të qarta, me një organizim të përsosur. Kjo u shndërrua në një lëvizje antifashiste mbarëpopullore dhe me ndërgjegje të lartë kombëtare. Ajo u bë pikë referimi edhe për krahina të tjera të Dibrës gjatë Luftës Antifashiste Nacionallërimtare.

DIBRANËT DEMOSTRUAN QARTAZI SE QENË PËRDERE PATRIOTË

Fashizmi nuk ndërmori më operacione për çarmatosjen apo ndëshkimin e Reç e Dardhës. Atij nuk i interesonte të hapte një vatër lufte të nxehtë përveçues në ato dy krahina të Dibrës, që përveç forcës njerëzore të pathyeshme, ato i favorizonte edhe terreni strategjik.

Në ato gryka të thella, male e maja të larta, shkëmbinj të thepisur e kodra kishin gjetur vdekjen të gjithë ata pushtues që kishin synuar për tu futur në këto treva edhe më parë.

Krahina e Dardhës dhe ajo e Reçit qëndruan të vendosura në vendimet që patën marre pas qëndresës në Kodrën e Kacës. Këto treva u bënë të pakalueshme, duke mos lejuar që fashizmi e veglat e tij të fusnin kthetrat e të depërtonin në to.

Kjo u provua në pranverën e vitit 1942, kur fashizmi do të ndërmerre një operacion në krahinën e Lumës me forca të shumta ushtarake dhe të milicisë civile fashiste. Këto forca sipas planit fashist, do të kalonin nëpër territoret e Dardhës e Reçit dhe të futeshin në trevat e Lumës.

Posa u informuan Dardha e Reçi, nën udhëheqjen e drejtimin e prijësave të tyre, sensibilizuan popullin, u organizuan dhe u vendosën në vende kyçe, frontalisht për luftë. U dërguan njoftime krerëve fashistë, si Halil Alisë e të tjerëve, se nëpër territoret e Dardhës e Reçit nuk mund të kaloni.

Forcat ushtarake fashiste dhe milicia që bashkëpunonte me to, u detyruaruan të ndryshonin intenerarin e lëvizjes. Një ditë më vonë ata do të futeshin në Lumë nga një rrugë tjetër jashtë territoreve të Dardhës e të Reçit.

Dibranët në përgjithësi, demonstruan qartazi, se qenë përderë patriotë, u shfaq lartë ndërgjegja kombëtare, se dibranët ishin të gatshëm edhe për beteja të tjera.

PORTRET

DASHURIE LUMANI,

VETERANIA E PUNËS QË NË VITET '70 GUXOI TË THY- ENTE MENTALITETET E KOHËS DUKE U BËRË VINÇIERE

Nga Xheladin ÇELMETA

Ishte 22 vjeçe kur për herë të parë filloi punë në Ndërmarrjen Shtetërore të Ndërtimit (NShN) në Shkozë të Durrësit. Dhe ndoshta kurrë nuk do ta kishte menduar që në atë vend pune të zhurmshëm, mes makinerive të rënda, vinçave gjigandë, skelave e kovave massive të llaçit gjithnjë në lëvizje, si në filmat me “fanta-shkencë” ajo edhe do të dilte një ditë në pension, në vitin 1995. Kjo ndërmarrje në ato kohë kryesisht kishte si qëllim ndërtimin e pallateve parafabrikate në vend. Nga viti 1965, kur me ndrojtje filloi punë në një kantier ndërtimi nga më të rëndësishmit në vend, siç ishte NShN-ja e Shkozëtit (Durrës), e deri në vitin 1995, kur ajo doli në pension, janë plot 30 vite pune. Dashurie Lumani, sot 76 vjeçe, rrëfen për gazetën “Veterani” peripecitë që ka kaluar në këtë kantier pune të vështirësishë së lartë; me strese, jo pak herë edhe me momente të trishta e delikate, por që ajo kurrë nuk preferoi ta ndërrojë me ndonjë vend tjetër pune më të qetë apo me më pak telashe. Mund ta kërkonte një gjë të tillë dhe mund edhe ta gjente, sikur të këmbëngulte, por ajo kurrë ndonjëherë, nuk e mendoj një gjë të tillë.

DASHURIA, NJË NGA 5 GRATË E PARA VINÇIERE

E veçanta e punës që ka bërë Dashuria në NShN-në e Durrësit (Shkozë), është se ka qenë në një profesion aspak të zakonit për kohën: vinçiere. Të ishe vinçiere në atë kohë, donte të thoshte të sfidoje burrat. Dhe në një farë mënyre, në psikologjinë e meshkujve shqiptarë, kjo gjë konsiderohej gati-gati “mëkat”. Madje edhe të përfllisnin. Të bëheshe vinçiere, do të thoshte “t’u hyje në pjesë burrave”. “Ashtu ishte mentaliteti atëhere”, thotë ajo dhe ne gratë e dinim fare mirë këtë gjë. Se burrat, punën e dejtimit të një makinerie të rëndë, pra, të vinçit nga një grua, asnjëherë nuk e shihnin me sy të mirë. Ne, gratë vinçiere e ndjenim se shiheshim vëngër nga disa njerëz me mentalitete aty”. Ajo vazhdon: “Më caktuan në sektorin e makinerive të rënda. Dhe unë nuk hezitova, nuk u tremba, por e pranova menjëherë sfidën. Isha e re, sapo kisha krijuar familjen time. Bashkëshorti im, Bajrami, ishte punonjës policie në Durrës, në një pozicion të tillë pune, që në atë kohë i thonin “i plotfuqishmi i zonës”. Ai atëhere mbulonte gjithë rajonin sipas detyrës së shërbimit policor. Kështu, lindëm, rritëm e edukuam 5 fëmijë, katër vajza dhe një djalë; të cilët falë nesh si prindër u bënë të zotët për veten e tyre, për familjen, por dhe për vendin e shoqërinë. Dhe jam e kënaqur”, thotë



Dashurie Lumani, sot veterane e punës

ajo. Bajrami ka ndërruar jetë disa vite më parë dhe ajo mungesën e tij sikur e “plotëson” me pritjet e përcjelljet e nipërve e mbesave, që zakonisht asaj nuk i mungojnë çdo fundjavë. Dy vajza i ka në Itali dhe dy të tjerat dhe djalin i ka këtu në Shqipëri, në Durrës. Ajo e quan jetën e saj tërësisht “të plotësuar”, sidomos kur kujton mirëkuptimin e harmoninë e mrekullueshme që kishte me bashkëshortin e saj. “Vetëm mirëkuptimi në çift, bën që familja të jetë e suksesshme në çdo drejtim”, thotë ajo, duke shtuar se “këtë gjë dua t’ja them çifteve të reja sot”.

“ASPAK E LEHTË TË DREJTOJE NJË BRIGADË ME 60 BURRA”

Kur biseda vjen tek puna, vendi dhe roli i gruas në shoqëri veteranian e punës Dashurie Lumani thotë se “pa gratë asnjë punë nuk ecën përpara”. Sipas saj, gratë në kohën e saj kanë përballuar punë nga më të vështirat. Thotë se ajo atëhere, ishte jo vetëm një vinçiere, por kishte edhe rolin e brigadieres. “Disiplina e punës ishte shumë e fortë, pasi kjo diktohej nga karakteri dhe lloji i punës në NShN. Puna te makineritë e rënda të NShN-së kërkonte një kujdes maksimal. “Nuk ishte e lehtë të drejtoje një brigadë me 60 burra”, kujton ajo, duke u ndalur në një episod. “Do vinte për kontroll një nga ata lart, nga ata të Partisë. Punëtorët ishin të shpërndarë nëpër frontet e punës secili në makinerinë e vet. Menjëherë më vjen përgjegjësi dhe më thotë gjithë emocion, gati i



trembur: “Dashurie, ku janë punëtorët se po vjen për inspektim një nga ata lart. Dua që për dhjetë minuta punëtorët të jenë prezent këtu”. “Jo për 10, por për 5 minuta e më pak do i keshë këtu”, i thashë. Dhe vërtetë brigada menjëherë u mblodh, sapo i sinjalizova, dhe ai që ishte si përgjegjës në sektorin tonë, sikur u çlirua nga një ankth. Desha të them që atëhere kishte kërkesë shumë të lartë llogarie në punë. Nuk kishte llafë, për pak gjë mund ta pësoje.

ADEM REKA, HEROI QË PËRHERË NA KA FRYMËZUAR E MOTIVUAR

Një moment mbresëlënës për të ka qenë kur ra në krye të detyrës Heroi i Punës Socialiste Adem Reka. “Unë kisha vetëm një vit që kisha filluar punë në NShN. Kur dëgjoj të buçiste radioja me lajmin se “Ra në krye të detyrës, duke manovruar me bigën e tij lundruese, Adem Reka”. Shteti menjëherë e shpalli atë “Hero të Punës Socialiste”. Ademi gjatë luftës kishte qenë partizan në brigadën e 3-të Sulmuese. Pas çlirimit, kish shkuar vullnetar në ndërtimin e hekurudhës Durrës-Peqin. Në vitin 1949 kish filluar punë në Flotën Detare e më vonë në Bigën lundruese. Siç tregonin, ai ishte shquar vazhdimisht për ndërgjegje të lartë, për guxim dhe devotshmëri deri në sakrificë. Kështu që, ai ra heroikisht në mbrojtje të pronës së për-bashkët, për të shpëtuar Bigën nga valët e tërbuara të detit më 17 nëntor 1966. Për këtë akt u shpall “Hero i Punës Socialiste”. Shembulli i tij, natyrisht që ishte frymëzim për të gjithë klasën punëtore në Shqipëri.



Dashurie Lumani, dalë pranë makinës së saj tip “ZIS” me vinç, në vitin 1973.

Gazetat të nesërmen u mbushën me fotografinë e heroit dhe me shkrime, të cilat propagandonin jetën dhe veprën e tij sublime. Adem Reka ka qenë heroit që përherë na ka frymëzuar dhe motivuar. Të them të drejtën, më pas, unë si vinçiere e ndjeja edhe më shumë veten krenare që punoja në një sektor të tillë të vështirë në NShN.

QËNDISJA, “HOBI I RI” I VETERANES 76 VJEÇARE

Për Dashurinë asnjëherë nuk ka kohë për të humbur. Ajo gjithnjë di të “sajojë” punë edhe pse ka 76 vite mbi supet. Fotografitë e asaj kohe ajo i ruan si gjëra të shenjta. Në njërin ajo ka dalë pranë makinës së saj të tipit ZIS me vinç të montuar. Nuk mban saktësisht vitin se kur ka dalë aty, por thotë se duhet ti përkasë vitit 1972 ose 1973. Tjetra është një foto familjare ku në mes është ajo dhe burri i saj Bajrami, me uniforme policie, ndërsa fëmijët anash. Në dhomë dhe në anekse ajo ka kornizuar disa punime arti. Janë qëndizma të bëra me dorën e saj tamam në këto vite të fundit. Në njërin nga ato paraqitet një balerinë shqiptare, që sipas saj, ka pasur sukses në skenat e huaja; kurse në tjetrën është qëndisur një godinë tipike shqiptare në formën tradicionale të kullave të veriut. “Qëndisja më jep kënaqësi; kështu sikur motivohem më shumë për jetën. Më vjen keq që vajzat e sotme në moshën e pjekurisë së tyre, apo nusët e reja, nuk dinë të qëndisin. Unë qëndis akoma, thotë ajo duke qeshur, dhe nuk mëzitem kurrë nga ky avaz”.



Punime artistike në qëndisje të Dashurie Lumanit sot.



Monumenti i “Heroit të Punës Socialiste” Adem Reka

SPECIALE

Lavdi jetës dhe veprës së pavdekshme të Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit Rrahman Parllaku



